

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM


Për Programin e studimit Bachelor në “Financë – Bankë”

Ofruar nga Kolegji Universitar “WISDOM”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Dr.Halit XHAFA

Prof.Dr.Drini SALKO



Tetor / 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bachelor në “Financë - Bankë”

Ofruar nga Kolegji Universitar “WISDOM”

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “WISDOM”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr.241 datë 31.05.2011
4	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në: “Financë - Bankë”
5	Cikli i studimit:	Cikli i parë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohe të plote
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
15	Aktivizimi i programit të studimit	2015 - 2016
16	Numri i studentëve për program studimi	31

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Financë - Bankë dhe plotësimin e kushteve të vena në licencim

Kolegji Universitar "WISDOM" ka nisur veprimtarinë e tij akademike si Shkollë e Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" bazuar në VKM nr.672, datë 29.7.2006, "PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "WISDOM UNIVERSITY".

Institucioni është akredituar me kusht sipas Urdhërit Nr. 355, date 25.09.2015, "PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL ME KUSHT TË SHKOLLËS SE LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "WISDOM UNIVERSITY", dhe me Urdher Nr. 237 date 09.05.2016 plotësohen kushtet per akreditimin institucional.

Pavarësisht se ishte brenda vlefshmërisë së akreditimit institucional, institucioni me kërkesë të tij mori pjesë në procesin e akreditimit që iu nënshtruan të gjitha IAL në vend me agjencinë angleze të sigurimit të cilësisë (QAA), dhe në përfundim të procesit mori riakreditimin institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit VBA Nr.103, datë 10.11.2017, me kohëzgjatje 3 vite akademike.

Programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Financë – Bankë" është licencuar me urdhër të MASH Nr. 241, datë 31.05.2011. Ky Urdhër është bazuar në Vendim e KA nr. 128, datë 03.12.2010, i cili për këtë program ka rekomanduar plotësimin e disa kushteve dhe pas këtij plotësimi, të behet hapja e tij.

Gjatë vizitës në institucion GVJ-së iu vu në dispozicion korrespondenca qe i është dërguar ministrisë përgjegjëse për arsimin, për plotësimin e këtyre kushteve.

Gjate vizitës në institucionin GVJ verifikoi këtë korrespondence dhe konstatoi se me VKA Nr. 172, datë 15.04.2011 janë plotësuar këto kushte dhe i është rekomanduar Ministrit të Arsimit dhe Shkencës që: programi i studimit Bachelor në "Financë – Bankë" të hapet. **(Dok i marre gjate vizites)**

Në programin Bachelor në Financë - Bankë, në vitet akademike 2011 -2012, 2012 – 2013, 2013 – 2014 dhe 2014 - 2015 janë regjistruar për herë të parë përkatësisht 6, 2, 0 dhe 0 studentë të cilët pasi kanë kryer vitin e parë janë transferuar në programin Bachelor në Administrim Biznesi në KUW në vite te ndërmjetme, kanë pezulluar studimet apo janë çregjistruar.

Si rrjedhoje programi Bachelor në Financë Bankë e ka filluar aktivitetin e tij te plotë në vitin akademik **2015-2016** dhe ne vazhdim.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

1. Prof.Dr.Halit XHAFA
2. Prof.Dr.Drini SALKO

GVJ është asistuar gjatë gjithë procedures nga specialistja e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Kolegji Universitar "WISDOM" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 18.10.2018, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 18/13 Prot, datë 18.10.2018. KUW përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 174 Prot, datë 19.10.2018 përgjigje në lidhje me Draft - Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Nëpërmjet kësaj shkrese Institucioni shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

Realizimi i procesit të vlerësimit të jashtëm u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu raporti i vlerësimit të brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyrore situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, Departamentin e Ekonomisë. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim kanë dhe vizitat në vend që u realizuan pranë Kolegjit Universitar "WISDOM" (KUW) në datat 27-28 Shtator 2018, takimet me drejtues të këtij institucioni si dhe shqyrtimi i dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet i gjithë programi i studimit.

Gjatë vizitës në vend u realizuan takime me drejtues të Institucionit, me drejtues të departamentit, njësinë e vlerësimit të brendshëm, stafin pedagogjik, studentë, sekretarinë mësimore, administratën, arkivin, në bibliotekë etj. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, në sallën e kompjuterëve, si dhe u zhvilluan anketime me studentë të disa grupeve.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, me të dhënat e studentëve në sekretari, me të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite dhe lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve.

Gjithashtu gjykimi i grupit të punës u mbështet në intervistat e marra nga grupet e ndryshme të interesit (drejtues, grupi i vlerësimit, stafi pedagogjik, studentë, punonjës të administratës, etj).

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
---------------------	--

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.**

Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;

Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;

Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;

Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Financë - Bankë” bazohet në misionin, qëllimin objektivat të përcaktuara qartë nga Kolegji Universitar “WISDOM” (KUW) nepermjet statutit te tij.

Misioni i këtij program studimi është të arrijë të përgatisë staf potencial të kualifikuar në fushën e financave dhe në sistemin bankar por edhe më gjerë. Njohuritë teorike praktike të fituara nëpërmjet këtij programi do mundësojnë plotësimin e tregut të punës në sektorin financiar dhe bankar në vendin tonë por edhe më gjerë. Studentët e këtij programi synohet të përftojnë njohuritë e nevojshme për tu punësuar kryesisht brenda vendit për shkak të formimit teorik, njohurive për ekonominë shqiptare, financën kontabilitetin, ligjeve përkatës, dhe njohurive teorike në financë banke.

Me përfundimin e programit përkatës arrihet që studenti të pajiset me aftësi si:

- Zotërimi i njohurive bazë teorike dhe deri diku praktike të problemeve financiare e bankare duke u dhënë mundësi
- a. Te gjejnë veten ne tregun e punës në sektorin financiar e bankar në pozicione bazë të tilla si ekonomiste të financës, në sektorin publik e privat të ekonomisë, arkëtarë apo shërbim llogarie pranë bankave tregtare, institucioneve te sigurimit etj.
- b. Zotërimi i njohurive bazë mësimore e shkencore për të qene të suksesshëm ne vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë të programeve universitare atë të Masterit Shkencor apo Masterit Profesional.
- c. Aftësia për të përdorur teoritë bazë dhe instrumentet financiare për të zgjidhur problemet e shfaqura në fushën financës dhe bankës.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;

Programi Bachelor në “Financë Banke” është në vitin e 4-të zhvillimit të tij. Ky program ka startuar në vitin akademik 2015-2016 dhe bazohet në

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;

Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;

strategjinë e zhvillimit të KUW që përfshin periudhën 2018-2023.

Në strategjinë e institucionit janë përcaktuar qartë drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të tij dhe në këtë këndvështrim edhe të këtij programi në fushën akademike dhe shkencore. Strategjia përcakton hapat e zhvillimit të mëtejshëm edhe për mundësinë e rritjes me tej të cilësisë së mësimdhënies, rritjen cilësore të stafit akademik dhe vazhdimësinë e institucionit në përgjithësi dhe që është njëkohësisht edhe si referim për këtë program.

Programi bazohet tashme në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit Bachelor në Financë-Bankë, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira bashkëkohore brenda fushës së financë bankës në funksion të qëllimit të tij.

Bazuar edhe në numrin relativisht të ulët të studenteve në këtë program gjatë 3 viteve të fundit, *GVJ rekomandon se është e nevojshme hartimi i një strategjie për këtë program e cila do të përcaktonte*

ne mënyrë të qarte objektivat afatmesme dhe drejtimet e realizimit të tyre për të krijuar siguri dhe për ta bërë të qëndrueshëm ecurinë e programit.

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- kërkesat e punëdhënësve;
- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë ofron për studentët lëndë të formimit të përgjithshëm dhe lende të specialitetit në financë dhe bankë. Disa

prej tyre kanë edhe karakter praktik me qëllim që studentët të përshtatën me tregun e punës. Ky program është reflektim edhe i praktikave dhe eksperiencave tashme të krijuara në hartimin e programeve të nivelit Bachelor në financë bankë dhe që mban parasysh edhe kërkesat në rritje në tregun e punës në këtë sektor për specialistët e financë bankës.

KUW ka hartuar një studim tregu lidhur me programin Bachelor në Finance Banke. Ky studim tregu arrin të trajtojë mundësitë e punësimit të studenteve që diplomohen në këtë program, karakteristikat dhe kapacitetet e disa sektorëve në financë dhe banka për rekrutim potencial të të diplomuarve në këtë program.. Ky studim përcakton edhe kuotat e mundshme të studenteve për një vit akademik që është 40 student.

	<p>Numri i studentëve gjatë 3 viteve të fundit në këtë program megjithëse i ulët ka pasur një rritje relativisht të ulët nga 10 studentë të regjistruar në vitin 2015-2016 në 15 studentë të regjistruar në vitin 2017-2018.</p> <p>Mendojmë se ky numër është ende i ulët po të kemi parasysh kriterin e krijimit të grupit studentor që është më i lartë. Rritja e numrit të studentëve të pranuar në këtë program është dhe sfida kryesore për një ecure normale të programit për KUW.</p>
--	---

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi Bachelor në Financë Bankë në kuadër edhe të programeve të tjera nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe promovon vlerat kulturore kombëtare. Ai është hartuar duke u bazuar në politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.</p>
--	--

Konkluzione të vlerësimit:

Programi Bachelor në Financë-Bankë është bazuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e KU "WISDOM".

Programi Bachelor në Financë-Bankë zbatohet në përputhje me strategjinë e këtij institucioni si dhe me synimet e zhvillimit ekonomik e kombëtar.

Programi Bachelor në Financë-Bankë pajis studentët me njohuritë bazë teorike, shkencore dhe praktike, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të edukimit universitar.

Rekomandojmë:

Hartimin e një strategjie të veçantë për zhvillimin e këtij programi që të kishte objektiva me të qarta dhe deri diku edhe impakt lidhur me rritjen e cilësisë të një pjese të stafit të Departamentit apo të plotësimit të tij për të realizuar në të ardhmen jo vetëm mundësinë e realizimit të objektivave të këtij programi por edhe perspektiven e zhvillimit të programit të ciklit të dytë në financë bankë.

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur kryesisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit



Programi Bachelor në "Financë – Banke" ofrohet nga Departamenti Ekonomisë, të Fakulteti të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, që është një nga dy departamentet e këtij Fakulteti

Fakulteti i Shkencave Eonomike dhe Shoqërore përbëhet nga:

1. Departamenti i Ekonomisë
2. Departamenti i Psikologjisë
3. Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë/FSHS

Organi me i lartë vendimmarrës është Senati i Kolegjit.

Organet dhe autoritetet drejtuese të Fakulteti të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore janë: Dekani, Zëvendësi, Përgjegjësit e Departamenteve, Dekanati dhe Përgjegjësi i NJKSH.

Departamenti i Ekonomisë është njësia bazë mësimore–kërkimore e programit që përfshin fushën e kërkimit në Financë, kontabilitet dhe bankë duke përfshirë këto disiplina përkatëse.

Parë në tërësi, mund të themi se kemi zbatim hierarkik të strukturës në institucion dhe asaj të Fakultetit dhe departamentit me organe të përcaktuara qartë që mbulojnë fushën e kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe atë administrative. Në të gjitha nivelet përkatëse kemi organet e zgjedhura të cilat e bazojnë operimin dhe kompetencën e tyre bazuar në rregulloret përkatëse.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

KU "WISDOM" ka një strukturë akademike hierarkike me organin me të lartë vendimmarrës Senatin dhe deri te njësia baze që është Departamenti.

Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe veprimtarinë kërkimore shkencore sipas fushave që ofron kjo njësi. Fakulteti organizohet në tre njësi bazë nga të cilat 2 departamente. Struktura, funksionimi, drejtimi, përbërja dhe detyrat janë të përcaktuara në rregulloren e kolegjit si dhe në Rregulloren e Njesisë Kryesore.

~~KUW e organizon aktivitetin akademik në dy fakultete, përkatësisht: Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore dhe Fakulteti i Drejtësisë~~

Të dhëna për personelin akademik të Fakulteti të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, i angazhuar aktualisht, sipas njësive bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore në vitin aktual akademik **2017-2018** ka në përbërjen e tij **25** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **21** persona, nga të cilët **14** janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **4**, nga të cilët **2** me tituj/grada, dhe **18** personel administrativ. **(Shih tabelën nr.1 ne aneks)**

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Ekonomisë që është dhe përgjegjës për këtë program studimi në vitin aktual akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij 9 personel akademik efektiv dhe me kontratë.

Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej 7 persona, nga të cilët 5 janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej 2 persona, nga të cilët 1 me tituj/grada. Ky numër gjatë 3 viteve të fundit ka qenë i njëjtë, periudhë kjo që përkon edhe me zhvillimin e këtij programi.

Duhet theksuar se në mbulimin e këtij programi janë angazhuar edhe 3 Personel Akademik Efektiv (PAE) nga NJKSHMJ-ja.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli Akademik përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë (PAE) si dhe personeli akademik i ftuar (PAK). Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës dhe në rregullore. Personeli Akademik është i angazhuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor sipas kërkesave dhe standarteve të Kolegjit. Personeli akademik mund të angazhohet edhe me punë të tjera të natyrës administrative, në ndihmë të nevojave të institucionit.

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 12 pedagogë gjithsej, nga të cilët 10 janë PAE, nga ku 6 me tituj/grada dhe 2 PAK, 1 me tituj/grada.

Ky personel ka qenë i njëjtë për të tre vitet akademike që ka qenë aktiv ky program studimi.

Nga 10 personel akademik efektiv (PAE), 7 personel akademik efektiv (PAE), i përkasin departamentit të ekonomisë dhe 3 personel akademik efektiv (PAE), i përkasin NJKSHMJ (referuar dok marre gjate vizites).

Duke vlerësuar stafin akademik të përfshirë në këtë program vëmë re se nga numri total prej 12 pedagogesh; vetëm 1 zotëron titullin Prof.Dr (PAE); 2 pedagogë zotërojnë titullin akademik Prof.asoc.Dr. nga keta 1 është PAE dhe 1 është PAK; 4 pedagoge zotërojnë Gradën Shkencore Doktor (PAE) dhe 5 pedagoge janë pa grada shkencore apo tituj akademik ku vetëm 4 prej tyre janë PAE.

Shihet që në total pedagoge pa grada shkencore dhe tituj akademik zënë rreth 42 % të personelit të angazhuar në këtë program, ndërsa pesha e pedagogëve që janë PAE pa grada shkencore dhe tituj akademik zë rreth 40 % të stafit që mbulon këtë program.

Kriteret e rekrutimit të personelit akademik që ne verifikuam janë në varësi të kërkesës për staf akademik. Preferohen për t'u zgjedhur stafi akademik me grada e tituj. Rëndësi i jepet edhe përvojës së stafit që pritet të merret në punë. Këtë ne e verifikuam duke parë disa dosje rekrutimi të

personelit akademik. Mbledhja e të dhënave të stafit bëhet nga një formë e cila quhet "Të dhënat individuale të stafit" ku çdo personel i ri hedh të dhënat e tij personale. Kjo formë qëndron në dosjen personale të çdo pjesëtari të stafit.

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

Numri totali i stafit akademik që zhvillojnë të gjitha lëndët e këtij programi është 12 pedagogë, nga të cilët 10 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 2 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK). Pra raporti PAE/PAK, është 10/2. Ky numër ka qenë që në aktivizimin e këtij programi. Bazuar në raportet e mësipërme, vihet re ky program mbulohet në pjesën më të madhe rreth 83 % nga (PAE) dhe rreth 17 % (PAK).

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelën, Aneksi 3)

Bazuar sa me sipër rezulton qe:

Raporti Personel Akademik / Student është $12/31=0.38$

Raporti PAE/PAK në këtë program është $10/2 = 5$

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik $10/12 = 83 \%$

Raporti student/ staf total është $31/12 = 2.5$ stud/1 pedagog

Raporti pedagog të përfshirë në zhvillimin e këtij programi/student për këtë program bazuar në numrin aktual të studenteve të këtij programi është mbi optimalen rrjedhoje kjo e numrit të ulet të studenteve të regjistruar.

Të dhënat sipas seksit, Të dhëna sipas moshës së personelit

Nga 12 anëtarë të stafit qe mbulon këtë program, 5 janë femra dhe 7 meshkuj

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në lidhje me punësimin e stafit akademik në verifikuam praktikën e ndjekura qe nga shpallja e vendit vakant deri në emërimin e kandidatit nga organet përkatëse. Kjo praktikë është konform rregullave të paravendosura nga organet përgjegjës të Burimeve Njerëzore dhe Bordit përkatës. Pas leximit të kontratës, stafi akademik e nënshkruan atë dhe Zyra e Financës dhe Burimet Njerëzore siguron nënshkrimin e kontratës nga Rektori i KU "WISDOM" si edhe vulosjen e saj

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Programi mbështetet drejtpërdrejt nga asistente të Departamentit të Ekonomisë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik bazohet në kërkesat e dy Departamenteve përkatëse. Zyra Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procesin e njoftimit, përpilimit të dokumentacionit të kandidatëve për rekrutim dhe kalimin e këtij dokumentacioni Bordit Administrativ të Fakultetit. Vlerësimi realizohet nëpërmjet Komisionit prej tre akademikësh që miratohet nga Rektori ku realizohet edhe intervista me ta. Bordi Administrativ i Fakultetit analizon këtë raport dhe vendimin e tij ja dërgon për shqyrtimin e miratim Bordit Administrativ të KUW. Ky i fundit pasi e shqyrton vendimin, ia transmeton atë Këshillit të Lartë të KUW i cili jep vendimin përfundimtar.</p> <p>Pas vendimit përfundimtar nga ana e Këshillit të Lartë të KUW, kandidati plotëson dokumentet e kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe nënshkruan kontratën tij pas deklarimit në organet tatimore.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në programin “Bachelor në Financë-Bankë” për të tre vitet e aktivizimit të tij ka qene i njëjtë konkretisht: 12 personel akademik gjithsej, nga të cilët 10 personel akademik efektiv (PAE) dhe 2 personel akademik me kontrate (PAK).</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>PAE përbën 83% (nga 70 % që është kriteri minimal i standardit) të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit në Financë Banke.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Punësimit dhe Vlerësimit të Performancës Akademike të miratuar nga Senati, Institucioni e plotëson këtë kriter dhe procedurë bazuar në kriteret ligjore dhe transparente të Kolegjit. Në evidentuam vlerësime të stafit akademik nga anketimet e realizuara nga studentët për ta si dhe vlerësimet e veprimtarisë se tyre mësimore dhe shkencore të lidhura me botimet e tyre.</p> <p>Institucioni ka të përcaktuar modelin e performances per personelin akademik të përfshire ne program. Ky model ka të specifikuar kriteret e vlerësimit të stafit akademik.</p>

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;

Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;

Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.

Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të gjithë të dhënat e hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program të cilat i ka të sistemuara ne dosjet përkatëse. Ne verifikuam që këto të dhëna përfshinin informacione personale, eksperiencën e mëparshme etj.

Ne verifikuam listën e plotë të personelit akademik të përfshirë në programin “Bachelor në Financë-Bankë“ të Departamentit të Ekonomisë si dhe nga Departamenti i Psikologjise.

Lidhur me rekrutimin e personelit akademik ne verifikuam procedurat përkatëse të cilat fillonin që me njoftimin e vendit vakant, kriteret përkatëse vlerësimin për zgjedhjen dhe miratimin e tyre deri në nënshkrimin e kontratës. Këto procedura janë të plota.

KU “WISDOM” përgjithësisht ka angazhuar si titullarë të lëndëve për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankës personel akademik që ka së paku gradën shkencore Doktor.

Janë vetëm 5 pedagogë që nuk e kanë gradën Doktor por që zotërojnë Diplomën Mastër i Shkencave që zhvillojnë lëndët në këtë program.

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;

Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).

KU “Wisdom” angazhon asistentët kërkimorë si personel ndihmës kërkimor-shkencor ne ndihme të realizimit të orëve laboratorike dhe mirë përdorimin e ambienteve laboratorike që ndodhen në mjediset shkollore. Kështu programi Bachelor në Financë-Bankë i përdor laboratorët jo vetëm gjatë zhvillimit të lëndës së “Informatikës” por edhe ne disa lende të tjera.

Angazhimi i 12 pedagogeve në këtë program të stafit akademik me kualifikimet e nevojshme akademike si dhe ngarkesës mësimore përkatëse të mbuluar nga anëtarët e stafit akademik dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore nga KU “Wisdom” për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.

Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;

Në evidentuam organizimin nga KU “WISDOM” të trajnimeve për stafin tij në disa drejtime. Këto trajnime kane qene kryesisht individuale ne fusha të studimit të tregut, te financës etj. Njëkohësisht, KU “WISDOM”

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik në faqen zyrtare të saj. Institucioni nëpërmjet hallkave të tij organizative si sekretaria mësimore si dhe sekretaritë e secilit program disponojnë bazën e të dhënave të programeve të studimeve të ofruara nga KU "WISDOM".

Konkluzione të vlerësimit:

Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, programi Bachelor në Financë Banke mbulohet nga njësia bazë mësimore shkencore që është Departamenti i Ekonomisë, në total 12 pedagoge dhe 1 asistent që duhet konsideruar shumë pozitiv nga fakti se gjate viteve të fundit numri i studenteve të regjistruar ka qene i ulet. Në zhvillimin e këtij programi PAE zë rreth 83 % të personelit total që mbulon këtë program.

Bazuar në kuadrin e brendshëm rregullativ, KU "WISDOM" zbaton kriteret të qarta dhe transparente lidhur me rekrutimin e punonjësve të rinj.

Për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, PAE dhe PAK ekziston dokumentacion i plotë dhe i arkivuar nga Zyra e Punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuar. Informacioni freskohet çdo vit bazuar në raportin vjetor të aktivitetit. Baza e të dhënave për PAE dhe PAK si dhe personelin ndihmës dhe administrative është e sistemuar në dosjet përkatëse. Titullarët e lëndëve që nuk kanë gradën shkencore "Doktor", kanë përfunduar programet e studimit të ciklit të dytë Mastër i Shkencave ose programe të barasvlershme me to dhe njëkohësisht, vijojnë studimet e Doktoratës

Bazuar sa me sipër konkludojmë se standardet kësaj fushe janë përmbushur.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

KU "Wisdom" e zhvillon veprimtarinë mësimore shkencore në dy godina kryesore dhe ambientet rreth tyre që në baze të planimetrisë kanë një sipërfaqe totale rreth 2708 m², nga të cilat 1678 m² janë sipërfaqe ndërtimi dhe 1030 m² janë ambiente çlodhëse rekreative për personelin akademik dhe studentët. Godina e parë 5 katesh është në funksion të veprimtarisë mësimore, ndërsa e dyta në shërbim të personelit akademik dhe administrativ. Në godinën e parë përfshihen salla leksionesh, seminaresh, konferencash me kapacitet nga 30 deri në 120 studentë; laboratorë të pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme, bibliotekë, kafeteri, ndërsa në godinën e dytë janë kryesisht zyra për stafin akademik dhe administrativ, si dhe qeverinë studentore. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me pajisjet e nevojshme (videoprojektor, kompjuter të lidhur me internet, sistem ngrohje dhe ftohje me kondicionim-ventilim me inverter etj.) në funksion të zhvillimit të procesit mësimor duke iu ofruar komoditetet e nevojshme studentëve dhe stafit akademik. Godina është e pajisur me internet wireless në të gjitha ambientet e saj dhe është e aksesueshme për të gjithë studentët. Zyrat për personelin akademik dhe administrativ janë të mjaftueshme e komode për punë individuale të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme logjistike.

Ne godinën ku edhe realizohet mesimdhënis ndodhet edhe biblioteke me kapacitet rreth 45 poste leximi, 40 poste interneti të pajisura me kompjuter. Çdo ambient pune i kolegjit është e pajisur me kompjuter me akses në internet. I gjithë stafi akademik dhe administrativ ka adresë elektronike me domain-in e kolegjit emer.mbiemer@Eisdome.edu.al.

Nga vizita ne vend ne konstatuam qe fondi i teksteve dhe literaturës qe i referohet programi Bachelor ne Finance Banke ka pësuar rritje gjate dy tre viteve te fundit. Mendojmë se bazuar ne numrin aktuale te studenteve ky fond seksesh dhe literaturash është me se i bollshëm ne funksion edhe te qëllimit për te cilin është vene. Bazuar ne inventarin e saj, biblioteka përfshin nje fond me rreth 2200 tituj dhe mbi 1300 periodeke revista/buletine shkencore ne gjuhë shqipe dhe të huaj, fond ky në format hardcopy dhe elektronik, i cili aktualisht plotëson nevojat e të gjithë përdoruesve. Literatura bazë dhe ajo ndihmëse në funksion të programit të studimit u ofrohet studentëve në formën e teksteve mësimore bazë në bibliotekën e kolegjit. Ato gjenden në formë hard copy (3-5 kopje për çdo titull) apo në formë elektronike në bibliotekat online, ku studentët e kolegjit mund ti aksesojnë pa pagesë [www.ebookcentral.proquest.com/lib.central/EISDOM/online]

Biblioteka e Kolegjit Universitar "WISDOM" është bërë pjesë e sistemit kombëtar bibliografik COBISS.AL. Baza e të dhënave COBISS.AL është e një rëndësie thelbësore për sistemin COBISS.AL (sistemi bibliografik kombëtar për vlerësimin e rezultateve të kërkimit në Shqipëri), sepse ka rol qendror në sistemin e katalogimit të përbashkët, në kërkimin e informacioneve bibliografike dhe në udhëheqjen e bibliografive të kërkuesve shkencorë shqiptarë. Baza përmban regjistrime bibliografike për materiale libra (monografi, seriale, artikuj) dhe jolibra (CD, DVD etj.)

GVJ gjate vizitës verifikoi se gjate 2-3 viteve te fundit është pasuruar fondi i bibliotekës me literature reference për programin Bsc ne Financë Bankë. Kryesisht librat e blera për këtë program janë te autoreve vendas, profesorë te Fakultetit te Ekonomisë te UT.

Mjediset për Programin e studimit

Nga inspektimi ne vend ne pame se ne funksion te zhvillimit normal te këtij programi KUW kishte mjedise te mjaftueshme dhe te pajisura mire me infrastrukturën e duhur. KUW kishte 11 salla leksioni/seminari, salle konference, laborator informatike, salle biblioteke, mjedise te tjera shërbime. Te gjitha këto ambiente ishin me sipërfaqe te bollshme dhe te pajisura mire.

(Shih tabelën nr 5 ne aneks).

Mjediset për stafin:

Ne një godine me vete ne verifikuam mjediset për stafin e KUW. Këto mjedise përfshinin zyrat për drejtuesit, pedagoget, njësite e shërbimit etj. Këto ambiente ishin me sipërfaqe te bollshme dhe te pajisura me infrastrukturën përkatëse.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
---------------------	--------------------------

V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;

Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.

KU "WISDOM" ka vënë në dispozicion të programit Bsc ne Financë Banke tekstet bazë dhe literature ndihmëse e cila gjendet në mjediset e bibliotekës së Kolegjit.

Kjo literaturë është bashkëkohore dhe pasqyrohet relativisht mirë në syllabuset përkatëse të secilës lëndë mësimore. Tekstet baze janë kryesisht tekste të autoreve vendas, profesorë të Fakulteteve të Ekonomisë si dhe disa tekste ndërkombëtare për studentet.

Biblioteka e KU "WISDOM" se fundmi ishte pasuruar me një fond të tere tekstesh ne fushën e Financës dhe Bankave

Librat që ndodhen në bibliotekë janë të inventarizuar Fondi i Bibliotekës është ngritur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve dhe stafit akademik e administrativ.

Në bibliotekë gjendeshin botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, dhe studentët janë të regjistruar dhe shfrytëzojnë këto mundësi.

Fondi i pasur i botimeve periodike dhe bibliotekës elektronike i ofron studentëve të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë të gjitha mundësitë për përmbushjen me sukses të kërkesave të programit të studimit si dhe për kryerjen e hulumtimeve të ndryshme në lidhje me përgatitjen e detyrave,projekteve, temave të diplomimit etj.

Oraret e punës të bibliotekës janë të shpallura në faqen web të Kolegjit. Ato janë të shfaqura edhe në hyrje të bibliotekës, e cila është e hapur për studentët nga e Hëna deri të Shtunën.

Mendojmë se institucioni duhet te pasuroje fondin e bibliotekës me botime ne gjuhe te huaj kryesisht ne anglisht si dhe tekste ndërkombëtare për studentet ne fushën e financës, parasë, politikës monetare, menaxhimit financiar etj, tekste këto te mirënjohura ne te gjithë boten akademike dhe studentore

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedisë të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

Nga inspektimi ne ambientet e godinave të KU "WISDOM" rezulton se ky institucion ka 1 laborator mësimor Informatike, të pajisur me 25 kompjuter PC, 9 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe një sallë konferencash deri në 120 vende.

Niveli i paisjeve mësimore dhe parametrat e tyre teknik ishin mjaft te mira duke i paraprirë edhe zhvillimeve te mundshme sasiore ne te ardhmen te programit "Bachelor në Financë Bankë".

Kolegji Universitar "WISDOM" ka laboratorë dhe të Gjuhës së Huaj, të pajisur me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe njëkohësisht ka licencen e realizimit te testeve ndërkombëtare te gjuhës angleze.

Disa lende të programit Bachelor në Financë Bankë zhvillohen ne laboratorin përkatës. Te tilla janë lendet e Statistikës dhe Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit dhe me programe financiare.

Nga shqyrtimi i ambienteve te mësimdhënies KUW garanton me këto kapacitete zhvillimin me se normal te gjithë procesit te realizimit te programit.

Konkluzione të GVJ:

Ambientet e ofruara nga KUW për zhvillimin e programit janë mese te bollshme dhe garantojnë realizimin e programit Bachelor ne Finance Banke. Sallat e leksioneve/seminareve, biblioteka, zyrat e personelit dhe administratës kane gjithë infrastrukturën e nevojshme ne funksion te qëllimit te tyre.

Nga ana tjetër pajisjet ne funksion te mësimdhënies dhe mesimnxenies janë bashkëkohore dhe me parametra teknik te pëlqyeshëm.

Laboratori i informatikës, laborator i gjuhëve te huaja si dhe biblioteka janë te plotësuar mire dhe mjaft funksionale ne shërbim te qëllimit te ngritjes se tyre dhe rrisin apo lehtësojnë procesin mësimor duke krijuar premisat për eficence e mundësi me te mëdha për studentet ne përfundimin me sukses te këtij programi.

Ambientet dhe infrastruktura ne funksion te programit mendojmë se është një nder pikat e forta ne realizimin e këtij programi.

Bazuar sa me sipër konkludojmë se standardet kësaj fushe janë përmbushur.

Rekomandim:

Mendojmë se institucioni duhet te pasuroje fondin e bibliotekës me botime ne gjuhe te huaj kryesisht ne anglisht si dhe tekste ndërkombëtare

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Bazuar ne dokumentacionin ekonomik dhe financiar qe ne verifikuam rezulton qe të gjithë të ardhurat e Kolegjit Universitar "WISDOM", sigurohen nga një burim financimi siç janë tarifatat dhe shkollimit që paguajnë studentët. KUW, nëpërmjet, Bordi i Administrimit përcakton politika dhe prioritet për mirëmenaxhimin e fondeve të institucionit, përkatësisht në drejtimet si shtimi/përmirësimi i infrastrukturës së institucionit, rritja e numrit të stafit akademik me tituj dhe grada, pasurimi i vazhdueshëm i bibliotekës (tituj të rinj/nr kopje të librave/tituj etj). Procesi financiar dhe kontabël i nënshtrohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore procesit të auditimit të jashtëm.

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Te ardhurat kryesore te KUW janë tarifatat për shkollim.

Ato janë rritur nga 46,609,602 ALL ne vitin 2015 ne 63,012,063 ALL ne vitin 2017.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

KUW ka te evidentuara shpenzimet e veprimtarisë sipas zerave perkates te standardeve te kontabilitetit (paga e sigurime, shpenzime operacionale, shpenzime infrastrukture et(sipas tabelës nr. 8 ne RVB).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	Aktiviteti i KU "WISDOM" bazohet ne mbajtjen e evidencave dhe analizave ekonomike sipas standardeve te kontabilitetit. Kjo veprimtari i është nënshtruar edhe auditit te brendshëm. Po ashtu edhe nga organet tatimore ka pasur inspektime te tyre lidhur me rregullshmërinë e detyrimeve fiskale, apo detyrimeve te tjera te sigurimeve shoqërore.
Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;	Institucioni harton dhe miraton çdo vit nga organet vendimmarrëse projekt buxhetin me te gjithë elementet e tij.
Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Nuk na rezulton qe institucioni ti jete nënshtruar auditit te jashtëm. <i>Mendojmë qe një drejtim i rendesishem i institucionit në rritjen e te ardhurave duhet te jete pjesëmarrja si partnere</i>

në projekte te përbashkëta brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet te cilave te mund te siguroje financime shtese për trajnime, shpenzime operative etj në funksion të mësimdhënies.

VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit

dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Si çdo sipërmarrje , edhe KUW përpilon raportet financiare dhe dokumentacionin kontabël ne funksion te vendimmarrjeve te ardhshme si dhe ne funksion te raportimit ne organet fiskale te vendit.

GVJ gjate vizites ne institucion verifikoi mbajtjen e dokumentacionit financiar e kontabël te KUW për tre vitet e fundit.

Bazuar vetëm ne zërin e vetëm te te ardhurave nga tarifat e studenteve pame qe situata financiare gjate tre viteve te fundit është përmirësuar lehtësisht rrjedhoje e rritjes modeste te studenteve te regjistruar apo transferuar.

Për një qëndrueshmëri financiare të KUW mendojmë se rritja e numrit të studenteve të regjistruar përben dhe drejtimin kryesor për arritjen e këtij objektivi

Konkluzione të vleresimit:

KUW mban dokumentacionin financiar dhe kontabël konform standardeve dhe kuadrit ligjor e rregullativ aktual. Kjo veprimtari financiare i është nënshtruar auditivit te brendshëm si dhe inspektimit nga Dega e tatim taksave te Tiranës.

Institucioni ka vetëm një burim financimi; tarifat e shkollimit te studenteve te regjistruar. Te ardhurat për tre vitet e fundit janë rritur lehtësisht si rrjedhoje e rritjes se lehte te studenteve te regjistruar apo te transferuar.

Rekomandime

- *Për një qëndrueshmëri financiare të KUW mendojmë se rritja e numrit të studenteve të regjistruar përben dhe drejtimin kryesor për arritjen e këtij objektivi*
- *Mendojmë që një drejtim i rendësishëm i institucionit ne rritjen e te ardhurave duhet të jetë pjesëmarrja si partnere në projekte te përbashkëta brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet të cilave te mund te siguroje financime shtese për trajnime, shpenzime operative etj ne funksion te mësimdhënies.*

Bazuar sa me sipër konkludojmë se standardet kësaj fushe janë përmbushur kryesisht.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Bazuar në legjislacionin shqiptar mbi arsimin e lartë dhe rregullores “Për funksionimin e NJKSBC” të KU “WISDOM”, në institucion është ngritur Njësia Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila ka detyra dhe funksione të përcaktuara qartë në kryerjen e gjithë procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë.

Nga vizita në institucion dhe përkatësisht nga takimet me Dekanin, Përgjegjës të Departamentit dhe drejtuesen e zyrës së njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe nga raporti i vlerësimit të brendshëm, u vlerësua se institucioni i kushton vëmendje sigurimit të brendshëm të cilësisë, me qëllim që të sigurojë një veprimtari mësimdhënëse cilësore, të denjë dhe në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi, bazuar në Statut dhe akte të tjera të brendshme rregullator.

Në fund të semestrit përkatës NJSBC- realizon anketimin nëpërmjet sistemit elektronik vlerësimin me të gjithë studentët e programit Financë Banke, që në total është 23 anketime për të tre kurset dhe që vlerësojnë çdo lende të zhvilluar gjatë vitit akademik. Anketimet përpunohen dhe hartohet raporti përkatës me vlerësimet e studentëve.

Pyetësori me studentet, organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit dhe për pedagogët.

NJSBC, realizon procesin e vlerësimit të performancës të personelit akademik nëpërmjet kritereve të cilët vlerësojnë arritjen nga pedagogu të objektivave të lëndës, angazhimit të pedagogut për përmirësimin e vazhdueshëm të leksioneve, seminareve etj. Aktualisht kjo njësi ka me prioritet hartimin e kritereve të vlerësimit të performancës lidhur me angazhimin konkret të pedagogut në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit si dhe të angazhimit të pedagogut në veprimtaritë mbështetëse për kolegjin.

NJSBC aktualisht ka 5 anëtarë (**shih tabelën nr 7 në aneks**).

Nga takimi me studentët në morëm komente pozitive të tyre që konfirmojnë të njëjtën gjë, më konkretisht: Stafi akademik shumë i mire e i kualifikuar, komunikim i afërt me pedagogët, metoda të mira të mësimdhënies, literatura e kohës, ndihma personale si konsultimet sa herë që studentët dëshirojnë nga stafi akademik, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC si:

- **Sa anketime kanë bërë me studentët e programit të studimit, problematika etj**

Numri i studenteve të anketuar të programit Bachelor Finance Banke përfshin pothuajse të gjithë të regjistruarit, por duhet marrë në konsideratë numri i kufizuar i tyre në këtë program gjatë 3 viteve të fundit. Në total janë 23 studente të anketuar (**sipas RVB**)

Te gjitha anketat janë përpunuar dhe me pas janë diskutuar në Departament. Janë rishikuar format e organizimit të mësimdhënies në syllabuset e lëndëve duke futur elementë si studime rasti apo

detyra kursi, problematikë kjo e dalë nga rezultatet e pyetësorëve me studentët. Këtë ne e verifikuam si ne takimin me studentet ashtu edhe me stafin akademik të angazhuar në këtë program

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NJSBC mbulon cilësinë e mësimdhënies dhe mesimnxenies ne institucion lidhur me programet qe zhvillohen. Këtë kjo njësi e realizon nëpërmjet metodave direkte dhe indirekte. NJSBC në mbledhjet e tij, periodikisht shqyrton dhe analizon të gjitha problematikat dhe rezultatet të dala nga pyetësorët, duke dhënë dhe rekomandime për strukturat përkatëse. Politika që ndiqet për përmirësimin e cilësisë është trajtimi dhe/ose zgjidhja e problemeve që evidentohen nga struktura të institucionit, nga ankimime të studentëve, apo dhe vetë pedagogët drejtuar autoriteteve drejtuese të kolegjit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. 	<p>NJSBC e Kolegjit drejton gjithë procesin e sigurimit të cilësisë. Kjo njësi prej 5 personash ka mundësi të plotë informacioni rreth rezultateve të vlerësimit nga studentët dhe stafi. Raporti i vetëvlerësimit si një sintezë e sigurimit të cilësisë është baze edhe për ndryshimet në programet studimore.</p> <p><u>Metodat indirekte</u> të vlerësimit janë zbatuar me anë të anketës së zhvilluar me studentë përfshihen aspekte të vlerësimit të lendeve , cilësisë së mësimdhënies për pedagogun dhe rekomandime nga studentët, elementë këto të rëndësishëm për sigurimin e cilësisë.</p> <p><u>Metoda direkte</u> janë ato të përfshira edhe në syllabus-in e lëndës lidhur me vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor; vlerësim të detyrave të kryera nga studentët; vlerësim për përfshirjen në aktivitete jashtëshkollore.</p>
<p>Të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); 	<p>Kolegji Universitar “WISDOM” publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë duke ruajtur privatësinë e të dhëna.</p> <p>Gjithashtu janë realizuar dëgjime të drejtpërdrejta nga titullarët e KU në auditor për lende të ndryshme.</p> <p>Një rendësi i jepet angazhimit të studentit gjatë</p>

<p>b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Etj.</p>	<p>vitit sidomos prezantimit të detyrave të kurseve të përgatitura dhe prezantuar në auditor.</p>
---	---

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të</p>	<p>KUW i është nënshtruar procesit të akreditimit si institucion dhe është akredituar. Kjo është një bazë e shëndoshe për akreditimin me tej të programeve të studimit të niveli të parë dhe të dytë. KUW e realizon sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mesimnxenie nëpërmjet</p>
<p>efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron; Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron; Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to; Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>funksionimit të dy njësive: - NJSBC - Komisioni për Mbarëvajtjen e Kurrikules NJSBC ndjek dhe monitoron nëpërmjet metodave direkte dhe indirekte cilësinë e mësimdhënies. Komisionit për Mbarëvajtjen e Kurrikules, strukture e re kjo që koordinon nevojën e rritjes së mesimnxenies nga studentet, dhe rregullimit në kurrikulen e programit. Vlerësimi nga studentet për personelin mesimdhënës bëhet periodikisht dy herë në vit, në çdo fund semestri, kurse vlerësimi për stafin bëhet një herë në vit bazuar në kriteret për performancën e tyre.</p>

Konkluzione të vlerësimit:

NJSBC e KU "WSDOM" si njësi e rëndësishme e institucionit, vlerëson periodikisht treguesit e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe administrative duke përdorur metoda direkte dhe indirekte të vlerësimit.

Bazuar në shqyrtimet e detajuara dhe verifikimeve në vend, konstatojmë se Kolegji nëpërmjet NJSBC-se dhe organeve të tjera vendimmarrës duke filluar nga Departamenti i Ekonomisë deri të Senati i Kolegjit kanë përdorur instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, për shqyrtimin,

miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programit Financë Banke, sidomos për përmbushjen e kushteve të dhëna në marrjen e licencës së hapjes të këtij programi.

Bazuar sa më sipër konkludojmë se standardet kësaj fushe janë përmbushur.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni i Programit Bachelor në Financë-Bankë është përgatitja e studentëve me njohuritë teorike, profesionale dhe shkencore në fushën e financave publike e private, si dhe të industrisë bankare dhe financiare.

Në funksion të këtij misioni, objektivi kryesor i programit të Financë-Bankës është të pajisë studentët me njohuri të plota në fushën e financës dhe bankave tregtare. Duke njohur tregun e punës në këtë fushe të diplomuarit në këtë program kanë mundësi për punësim në institucionet financiare private dhe publike si dhe në hallkat e tjera të Sistemit Financiar shqiptar por dhe me gjerë. Në zhvillimin e programit Financë Banke ofrohen teknikat bashkëkohore të mësimdhënies, si laboratorë kompjuteri, lidhje interneti dhe një bibliotekë me një fond të mjaftueshëm literature.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

- Programi i studimit Bachelor në “Financë Banke” është licencuar me Urdhër të MASH Nr. 241, datë 31.05.2011, por realisht ka startuar në vitin akademik 2015-2016 duke përmblyllur ciklin e plote të studimit në vitin aktual.
- Objektiva të tjera të programit Bachelor në Financë-Bankë konsistojnë edhe në :
- Përfitimin të aftësive praktike për të kuptuar problemet e riskut në sektorin bankar dhe financiar.
- Përfitimin e njohurive teorike dhe shkencore lidhur me financat dhe bankat, tregjeve të tyre dhe analizës së performances dhe veprimtarisë bankare.
- Aftësimin e studentëve në përdorimin e programeve kompjuterike në përdorimin zyrtar të përditshëm dhe për vlerësimin e të dhënave statistikore në Departamentin e Ekonomisë.

Emërtimi i diplomës për programin Financë-Bankë

Departamenti i Ekonomisë ofron për studentët këtë program studimi Bachelor ku në fund studentët pajisen me titullin “Bachelor në Financë-Bankë ” Në planet mësimore jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 180 ECTS, në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Ekonomisë dhe me vendim miratimi të instancave me të larta të institucionit Senatit i KU “WISDOM”
- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit.
- 1 orë mësimore = 60 minuta.
- Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë punë.
- Një vit akademik ka 60 ECTS.

Planet mësimore, ku të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (plani mësimor i tre viteve ne aneks)

Plani mësimor është ndërtuar sipas kriterëve të përcaktuara duke detajuar të gjithë informacionin e nevojshëm. (Shih tabelën nr.9 ne aneks).

Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F)

Bazuar në kriteret e përcaktuara është bërë kategorizimi i lendeve që zhvillohen në këtë program sipas veprimtarisë formuese. Ky kategorizim ka respektuar strukturën e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore. (Shih tabelën nr.11 ne aneks)

Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara (Tabela 12)

KU “WISDOM” gjatë viteve pas marrjes së licencës ka bërë ndryshime në kurrikulen e miratuar duke respektuar kufirin e lejuar në përqindje të këtij ndryshimi. Këto ndryshime janë se pari reflektim i kushteve të dhëna që në licencim si dhe nga nevoja e përmirësimeve në program me qëllim karakterizimin e tij në financë banke.

Në vitin e parë janë ndryshuar lende me një total 14 kredite

Në vitin e dytë janë ndryshuar lende me një total 11 kredit

Referuar sa më lart, ndryshimet në planin mësimor gjatë këtyre viteve janë në masën rreth 13% të kreditive totale (poshtë kufirit të lejuar 20%).

Mënyra e përcaktimit të kreditiveve (ECTS) për format e studimit:

- Leksionet: 9-10 orë në auditor dhe 15-16 orë punë e pavarur e studentit

- Seminaret: 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Praktika 25 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Diploma 0 orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Ne planin mësimor lidhur me personelin shohim se numri total i personelit akademik i përfshirë në këtë program është 12 pedagogje gjithsej nga të cilët 9 i përkasin Departamentit të Ekonomisë dhe 3 NJKSHMJ-se, pra **83% e këtij programi mbulohet nga PAE.**

Megjithëse në plotësimin e kushteve të vena kur ju dha licenca e hapjes së këtij programi, KUW ka bërë disa ndryshime në program, përsëri mendojmë se ky i fundit duhet të axhustohet me tej në funksion të përmbushjes së qëllimit për të cilin është hapur. Kështu:

- a. *Për ta karakterizuar me mirë programin ai duhet "të lehtësohet" disi nga lëndë të menaxhimit duke shtuar lende të fushës së financës dhe kontabilitetit. Kështu të paktën një nga lendet "Menaxhim i Burimeve Njerëzore" apo "Menaxhimi Strategjik" që zhvillohen në Kursin e II-te mund të zëvendësohen me lenden "Bazat e Kontabilitetit" e cila mund të zhvillohet në kursin e I-re të semestrit të dytë në vend të lendes "Bazat e Marketingut", që do të mund të spostohesh në Kursin e II-te. Vendosija e kësaj lende i paraprin lendeve të kontabilitetit që zhvillohen në Kursin e II-te*
- b. *Lënda "Tregjet Financiare" mund të rrimërohet "Institucionet dhe Tregjet Financiare" duke përfshirë në program edhe trajtimin e institucioneve të tjera financiare, si ato të sigurimeve, pensioneve etj.*
- c. *Në pamundësi për ta futur si lende me vete "Kontabilitetin e Drejtimit" mund të rrimërohet lënda aktuale "Kontabiliteti i Kostos" në emërtimin "Kontabiliteti i Kosto Drejtimit". Kjo do jepte mundësinë që të trajtoheshin edhe temat e kontabilitetit të drejtimit.*

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset janë hartuar për çdo lëndë dhe përmbajnë këto elementë bazë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentin për përvetimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën

- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analiza e cilësisë së syllabuseve

KU "Wisdom" ka të depozituar të gjithë syllabuset e programit. Nga shqyrtimi me hollësi i syllabusve evidentojmë se ato i kanë të gjithë elementet e domosdoshëm që pasqyrojnë programin e një moduli. Megjithatë vëmë re mangësitë e mëposhtme:

- *Një pjesë e mirë e syllabusve nuk janë ndërtuar plotësisht sipas vendimit të KM nr 41 date 24.01.2018.*
- *Pavarësisht se lënda zhvillohet nga një pedagog me Msc, ose se bashku me pedagog të tjerë, në renditjen e hartuesve të syllabusit duhet të jete i pari ai pedagog që ka gradën shkencore Dr. Nga ana tjetër, si rrjedhojë e kësaj një pedagog është hartues i 3 deri 4 syllabusve .*
- *Në një pjesë të syllabusve duhet të referohet një literature me e fundit në kohë pasi shihen referime të literaturës të 7 deri 10 viteve me pare.*

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi bachelor në Financë Banke ofrohet faktikisht që nga viti akademik 2015-2016 pranë Departamentit të Ekonomisë duke reflektuar dhe plotësuar të gjitha kushtet e dhëna që ne marrjen e licencës së hapjes së tij.</p> <p>Studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjekin programin Bachelor në Financë-Bankë me kohë të plotë është 60 kredite.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë është njësitë kryesore që mbulon këtë program brenda këtij institucioni.</p> <p>Studentët potencial dhe ata aktuale informohen mbi përmbajtjen e programit të studimeve në fillim të çdo viti akademik nga Përgjegjësi i Departamentit dhe nga Sekretaria Mësimore.</p> <p>Institucioni përgatit edhe guidë të studentit për një informacion të plotë dhe të qarte rreth programeve që</p>

Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

ofron KUW dhe në këtë kuadër edhe për programin Bachelor ne Finance Banke. Gjithashtu pedagogët e modulit dhe lëndëve informojnë studentët në lidhje me kërkesat e lëndëve përkatëse dhe mënyrën e vlerësimit.

Ne zbatim edhe të kuadrit ligjor një zhvillim pozitiv duhet konsideruar ngritja kohet e fundit me vendim Senati të Komisionit për Mbarëvajtjen e Kurrikulave. Kjo njësi e re ka ne fokusin e saj monitorimin dhe dhënien e informacionit mbi zbatimin dhe ndryshimet e mundshme ne kurrikulat e programeve qe zhvillohen ne KUW

Në fillim të vitit akademik studentët informohen vazhdimisht nga Departamenti mbi lëndët me zgjedhje apo të detyrueshme për secilin semestër. Studentët bëjnë zgjedhjen e lëndëve dhe programit të studimit të ofruar nga ky program i Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.

Ne aplikimin e tij për akreditimin e këtij programi institucioni nuk ka arritur të reflektoje përgatitjen e syllabusve sipas vendimit të KM nr 41 date 24.01.2018, rrjedhoje kjo e kohës se pamjaftueshme qe ka pasur.

Konkluzionet e vlerësimit:

Departamenti i Ekonomisë i KU "WISDOM" ofron programin e studimit në Bachelor në Financë Banke , i cili është aktivizuar që nga viti akademik 2015-2016.

Studimet në këtë program organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Kreditëve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin Bachelor në Financë-Banke me kohë të plotë është 60 kredite ECTS.

Departamenti i Ekonomisë, si njësi kryesore qe mbulon këtë program si dhe hallkat e tjera të institucionit dhe vete stafi akademik ofron informacionin e plotë rreth këtij programi për të interesuarit nëpërmjet disa burimeve të mundshme, kontakteve të drejtpërdrejta me studentet apo kandidatet për student, faqes se internetit , gudes se studentit, lajmërimeve , reklamës etj.

Rekomandime:

- 1. Për ta karakterizuar me mire programin ai duhet "te lehtësohet" disi nga lende të menaxhimit duke shtuar lende të fushës se financës dhe kontabilitetit. Kështu të paktën një nga lendet "Menaxhim i Burimeve Njerëzore" apo "Menaxhimi Strategjik" qe zhvillohen ne Kursin e II-te mund të zëvendësohen me lenden Bazat e Kontabilitetit e cila mund të zhvillohet ne kursin e I-re të semestrit të dyte ne vend të lendes Bazat e Marketingut qe do te mund të spostoresh ne Kursin e II-te. Vendosja e kësaj lende i paraprin lendeve të kontabilitetit qe zhvillohen ne Kursin e II-te*
- 2. Lënda Tregjet financiare mund të rriemërohet "Institucionet dhe Tregjet Financiare" duke përfshire ne program edhe trajtimin e institucioneve te tjera financiare, si ato te sigurimeve,*

pensioneve etj.

3. Në pamundësi për ta future si lende me vete "Kontabilitetin e Drejtimit" mund të rrimërohet lënda aktuale "Kontabiliteti i Kostos" ne emërtimin "Kontabilitet i Kosto Drejtimit". Kjo do jepte mundësinë qe të trajtoheshin edhe temat e kontabilitetit të drejtimit.
4. Ne hartimin e syllabusve të zbatohen kriteret e vendosura sipas vendimit të KM nr 41 date 24.01.2018 ne strukture dhe përmbajtje.
5. Te rekomandohet dhe referohet literature me bashkëkohore ne syllabuset e mjaft lëndëve.

Bazuar sa me sipër konkludojmë se standardet kësaj fushe janë përmbushur kryesisht.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia në programin Bachelor në Financë - Bankë bazohet në Rregulloren e Programit të Studimit Finance Banke e miratuar nga instancat përkatëse të KUW. Ne këtë rregullore përcaktohen format e mësimdhënies dhe vlerësimi i dijeve të studentëve.

Provimet përgjithësisht janë mbajtur në formë të shkruar. Megjithatë, pedagogu i lëndës mund të vendosë për të kryer provimin në formën e një provimi me gojë, projekt ose detyrë kursi.

Vlerësimi i studentëve në programin Financë Banke bëhet në bazë sistemit me 10 nota qe i referohen diapazonit të pikëve përkatëse, të krediteve dhe ECTS-së, e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në rregulloren përkatëse

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- | | |
|--|----------|
| • Leksionë ore totale në auditor | 1298 orë |
| • Seminare ore totale në auditor /ushtrime | 681 orë |
| • Laboratorë | |
| • Praktikë lëndore. | 0 orë |
| • Praktikë profesionale | 150 orë |

Format e kontrollit të njohurive

Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë të caktuar merren në konsideratë të gjitha elementet përbërëse të zhvillimit të lëndës: pjesa teorike, pjesa e seminareve, projektet, kontrollet e pjeseshme, etj. Këto elementë vlerësimi gjenden në secilin nga syllabuset e lëndës të përgatitur nga titullari i saj dhe miratuar nga përgjegjësi i departamentit. Rezulton se mënyra e vlerësimit të vazhduar të lëndës (me shumë elemente vlerësimi) bën të mundur kontrollin e dijeve me mirë nga ana e pedagogut dhe në të njëjtën kohë nxit studentin për përgatitje më sistematike gjatë gjithë semestrit në të gjithë elementët e vlerësimit të lëndës.

Provimet zhvillohen brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik. Kontrolli i dijës së një lënde (provimi) mund të bëhet nëpërmjet:

- Provimit me shkrim

- Provimit me gojë
- Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë
- Vlerësimin të projektit/detyrave të kursit/eseve në grupe prej dy ose më shumë studentësh.

Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në tezën e cila gjatë provimit sekretohet nga sekretaria për çdo student, si dhe çkodohet pas korigjimit nga pedagogu, i cili hedh pikët e provimit në procesverbal ku paraprakisht ka plotësuar edhe pikët e mbledhura nga elementët e tjerë të vlerësimit.

Nga verifikimet që GVJ beri pranë sekretarisë mësimore vumë re tre mangësi rreth vlerësimit të studenteve:

- Në disa nga regjistrat e mësimit të pedagogeve, këta të fundit nuk vendosnin rregullisht mungesat në frekuentimin e studenteve. Kjo neglizhence lë shteg për mosfrekuentim nga studentet në mënyrë të rregullt.
- Në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit të studenteve mungonin të dhënat për vlerësimin gjatë vitit që presupozohej se e kishte pedagogu i lendes në shënimet e tij.
- Kishte diferencë të mëdha në kalueshmëri mes lëndëve.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Në axhendën e Njesisë Kërkimore është paraparë përfshirja dhe aktivizimi i studentëve në aktivitete shkencore të llojit simpoziume, sesione shkencore, konferenca, promovime të botimeve në IAL dhe jashtë tij. Studentët përfshihen dhe kanë rol parësor në organizimin e seminareve studentore dhe mbështeten nga politikat financiare të IAL-së. Studentët ndjekin trajnime nga organizata me orientim kërkimor shkencor si për shembull nga AKTI dhe EURAXES për efekt të përditësimit të informacionit dhe drejtimit të tyre në praktika të reja kërkimore.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve në programin Bachelor ne Finance Banke që ofrohet nga KUW bazohet në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi si dhe në kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga institucioni.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve**



Gjate vizitës ne institucion ne verifikuam me zgjedhje pranë sekretarisë mësimore procesin e regjistrimit të studenteve në këtë program duke pare përmbajtjen e dosjeve të studenteve të regjistruar. Në dosjen e regjistrimit gjendeshin dokumentet e plotësuara të mëposhtme:

- Formulari i aplikimit;
- Kopje e noterizuar e diplomave të shkollës se mesme të përfunduar;
- CV-në e kandidatit, ku paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale.
- Një Letër Interesi (afërsisht 500 fjalë) ku paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e ciklit të dytë.
- Për kandidatet fitues që ndjekin studimet, Kolegji Universitar "WISDOM", lidh kontratën me studentin, në të cilën parashikohen detyrimet e ndërsjella të palëve

Të gjitha dokumentet e mësipërme dorëzohen pranë sekretares mësimore. Pas vlerësimit formal të listës së dokumenteve të nevojshme, dokumentacioni i kalon Departamentit përkatës i cili bën vlerësimin e aplikimeve dhe harton listën e kandidatëve të përzgjedhur. Sekretaria mësimore e KUW-se disponon statistika të detajuara vjetore për numrin e të diplomuarve për çdo program dhe cikël studimi në bazë viti akademik. Ne verifikuam rregullshmërinë e mbajtjes se regjistrimit themeltar ku bëmë sondazhe me zgjedhje për emra të caktuar duke verifikuar studentin e regjistruar me dokumentacionin qe përmbante dosja e tij.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Institucioni ka zbatuar kriteret ligjore,/ nënligjore dhe ato shtese të miratuara nga Senati i KUW lidhur me hyrjen/regjistrimin e studenteve

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Megjithëse ka pasur studente te regjistruar qe ne vitin 2012-2013, 2013 2014, programi filloi te funksionojë për here te pare ne vitin akademik 2015-2016

Numri total i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është **31 studente**, sipas viteve akademike konkretisht:

Për vitin akademik 2015 – 2016	10 studentë
Për vitin akademik 2016 – 2017	6 studentë
Për vitin akademik 2017 – 2018	15 studentë

Keto te dhena u verifikuan gjate vizites ne institucion

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Viti akademik 2017-2018 është viti i pare qe mbyll ciklin këtij programi dhe diplomimi i tyre behet ne Tetor te këtij viti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
---------------------	--------------------------

IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE

Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.

Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.

Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.

Pranimi i studentëve të rinj në programin e studimit Bsc në Financë Bankë bëhet sipas ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë"

KUW për vitin akademik 2017-2018 ka miratuar disa kriteret shtesë për këtë program si:

- Nota mesatare e shkollës së mesme, (për të gjithë vitet) do të përbëjë 70 % të vlerësimit përfundimtar.

- Nota mesatare e grup lëndëve të vlerësuara si më të rëndësishme nga Komisioni Përzgjedhës, ad-hoc, i cili ngrihet për çdo njësi kryesore, duhet të zërë 20 % të vlerësimit përfundimtar.

- Intervista me çdo kandidat, e organizuar nga Komisioni Përzgjedhës, ad-hoc, ze 10% të vlerësimit përfundimtar.

Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;

Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;

Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Ne momentin e regjistrimit apo të fillimit të vitit akademik studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nga departamenti dhe sekretaria mësimore.

Për të vlerësuar pedagogun e lëndes institucioni nëpërmjet NJBSC organizon anketimin me studentet. Ne pyetësorin e hartuar nga institucioni studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit, mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor, aftësitë akademike, etikën, komunikimin etj(para se të zhvillohet provimi). Përgjigjet e marra nga studentët janë analizuar dhe janë marrë, gjithashtu edhe rezultatet përkatëse. Rezultatet e performancës janë shpërndarë për pedagogët nga përgjegjësit e departamenteve përkatëse.

Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. Ne funksion të kësaj është ngritur Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Jetës

	Studentore që ofron shërbimin e këshillimit për karrierën të studentëve. Kjo njësi ofron mundësinë për të provuar punën e dëshiruar nëpërmjet praktikave të punës, mundësinë dhe aftësinë e ndërtimit të një rrjeti njohjesh në ambientet profesionale të tregut të punës.
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p>	<p>Gjate vizites ne institucion GVJ verifikoi se Kolegji Universitar “WISDOM” dispononte statistika për numrin e të diplomuarve ne programet e studimit në ciklin e parë. Të dhënat raportohen në institucionet përkatëse.</p> <p>GVJ verifikoi pranë njësisë se sekretarisë lidhur me evidentimin e ecurisë se studenteve gjate zhvillimit te programit mësimor. Ky evidentim realizohet nëpërmjet statistikave te hartuara nga institucioni. Këto te dhëna janë ne dy forma</p>
<p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p><u>Ne formën e dokumentacionit te shkruar si regjistra</u> evidenca dhe forma te tjera dokumentimi materiale dhe</p> <p><u>Ne forme elektronike</u> si një database e institucionit për programin e studimit “Bachelor në Financë Bankë”.</p>
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë</p>	<p>Institucioni nëpërmjet Sektorit te Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore ofron shërbimin e këshillimit studentëve. Kjo zyrë përgatit propozimet për përmirësime të kurrikulave. Krahas kësaj secili Kurs i programit të studimit ndiqet dhe asistohet nga nje pedagog kujdestar.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Pranimi i studentëve të rinj në programin Bachelor në Financë Bankë bëhet sipas ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

KUW aplikon edhe kriter shtesë në lidhje me pranimin e studentëve të rinj në programin Bachelor në Financë Bankë.

Studentët në këtë program informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit që ndjekin, mënyrën e organizimit dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet javës së orientimit në fillim të vitit akademik, Guidës së Studentit, si edhe informacionit të publikuar në faqen zyrtare të KUW

